



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 158, Datë 09.07.2018

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “DON – UCD” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “DON – UCD” sh.p.k, në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 475 datë 27.06.2018, shoqëria “DON - UCD“ sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Bordi i ERE me Vendimin nr. 149, datë 28.06.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “DON – UCD” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje me shkresën nr. 55/44 Prot., datë 28.06.2018 u publikua në media njoftimi për fillimin e kësaj procedure.
- Me shkresën nr. 475/1 Prot., datë 28.06.2018, iu kërkua subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar që kishte të bënte me nenin 9, pika 4.8, gërma “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar).
- Në vijim të kësaj korespondence, subjekti me shkresën nr. 475/2 Prot., datë 28.06.2018, ka paraqitur në ERE tabelën me sasitë e parashikuara të energjisë, për tu tregtuar për 5 vite të aktivitetit.
- Aplikimi i shoqërisë “DON - UCB” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin,

Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike (neni 9 pika 4.8). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “DON - UCD” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.